



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:228611  
Datë: 09.06.2022  
Numri i dokumentit: 03115305

**K.Nr.1020/21**

**Gjykata Themelore Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Kundërvajtës**, sipas gjykatësit Menderes Behluli dhe zyrtares ligjore Erzë Mustafa, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse ndaj të pandehurit Sh. A nga Gjilani, për shkak të kundërvajtjes nga neni **231 p.5** të Ligjit 05/L-088 për Rregullimin e Trafikut Rrugor lidhur me nenin 19 të Ligjit nr.06/L-069 për ndryshimin dhe plotësimin për Rregullat e Trafikut Rrugor, e në bazë të nenit 55 pika 1 dhe 2, 86, 119 dhe 48 p.2 të Ligjit për Kundërvajtje, më datë **09.06.2022** merr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I pandehuri Sh. A, nga babai V..., i lindur më ..., në Gjilan lagjja “...” ku edhe jeton, me nr.personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S**

Sepse me dt. **30.09.2021**, rreth orës **03:30** min, në rrugën “Lidhja e Prizrenit”, i lartëshënuari është ndalur nga Policia, me automjetin e llojit “**AUDI**” me targa të regjistrimit ..., dhe në vend të ngjarjes është konstatuar se ka vozitur automjetin pa patent shofer.

-me këtë veprim ka bërë vepër kundërvajtëse nga neni 231 p.5 të Ligjit 05/L-088 për Rregullimin e Trafikut Rrugor lidhur me nenin 19 të Ligjit nr.06/L-069 për ndryshimin dhe plotësimin për Rregullat e Trafikut Rrugor, e për atë shpallet përgjegjës dhe,

### **D Ë N O H E T**

**Me dënim GJOBE** në shumë prej **200 (dyqind) €**.

Obligohet i pandehuri që dënimin e shqiptuar me gjobë ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë në kuptim të nenit 163 p 4, të LMK-së.

Obligohet i pandehuri që kësaj gjykate ti paguaj shumen prej **5 (pesë) euro**, në emër të paushallit gjyqësor në afatin e njëjtë si dënimin me gjobë.

Nga një kopje të aktgjykimit ti dorëzohet palëve në procedurë.

## **A r s y e t i m**

**Stacioni Policor në Gjilan**, me kërkesën e vetë **nr....** të datës **30.09.2021** dhe ka kërkuar që ndaj të pandehurit të zhvillohet procedura kundërvajtëse, që i njëjti të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas Ligjit.

Gjyqtari shqyrtoi kërkesën e parashtruar dhe konstatoi që e njëjta është e ligjshme si dhe ftoi të pandehurin me ftesë për dt.**28.03.2022** që të paraqitet në gjykatë për ta dhënë mbrojtjen e tij, mirëpo i njëjti edhe pse ftesën me rregull e ka pranuar mos ardhjen nuk e ka arsyetuar dhe gjyqtari për të njëjtin vendosi në mungesë pa e marr të njëjtin në pyetje konform nenit **48 par.2**, pasi që vepra kundërvajtëse bindshëm vërtetohet nga fletëparaqitja dhe procesverbali i Policëve mbi ndaljen në vendin e ngjarjes.

Andaj gjyqtari nga shtjellimi i shkresave në lëndë, procesverbali mbi vendin e ngjarjes nga policët e rastit u vërtetua se në veprimet e të të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet, tiparet e veprës kundërvajtëse që i vihet në barrë të parashikuar dhe e sanksionuar me nenin 231 p.5 të Ligjit 05/L-088 për Rregullimin e Trafikut Rrugor lidhur me nenin 19 të Ligjit nr.06/L-069 për ndryshimin dhe plotësimin për Rregullat e Trafikut Rrugor dhe i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari me rastin e shqiptimit të dënimit mori për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 31 pika 1 të LMK-së dhe i shqiptoi dënimin nën minimumin e paraparë ligjor konform nenit 35 të LMK-së, duke konsideruar që edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit që i njëjti në të ardhmen të përmbahet mos të kryej vepra të kësaj natyre.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 59 të Ligjit për kundërvajtje. Me të lartë përmendurin u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE GJILAN, DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE** **Më dt.09.06.2022**

**Zyrtarja ligjore,**  
***Erzë Mustafa***

**Gjyqtari,**  
***Menderes Behluli***

**UDHËZIMI MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Ankesa dorëzohet përmes këtij Divizioni Kundërvajtes.